

BULETINI MUJOR

MARS 2025

VEPRIMTARIA E ASPA

TRAJNIM HYRËS PËR EKSELENTËT NË ADMINISTRATËN SHTETERORE

Gjatë muajit mars u zhvillua programi i trajnimit *“Ekselenca në Administratën Publike”*, një trajnim intensiv që synon të zhvillojë aftësitë profesionale të 100 ekselentëve të punësuar së fundi në institucione publike.

Ky program trajnimi u zhvillua në bashkëpunim me Ministër i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin.



MEMORANDUMI I BASHKËPUNIMIT

Finalizohet nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit mes Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) dhe Institutit Kombëtar të Shërbimit Publik (INSP) në Francë. ASPA dhe INSP do të bashkëpunojnë në fushat e trajnimeve, studimeve, botimeve dhe aktiviteteve të tjera, përmes shkëmbimit të njohurive dhe eksperiencave për përmirësimin e shërbimit publik dhe për rritjen e profesionalizmit të punonjësve të administratës.



Në muajin mars ka vijuar trajnimi i detyrueshëm *“Prezantimi me Administratën Publike”* për punonjësit në periudhë prove dhe janë trajnuar 71 pjesëmarrës.



TESTIMI PËR PROKURIMIN PUBLIK

Gjatë muajit mars vijoi grupi i dytë i testimit për certifikimin e trajnimit në fushën e prokurimit publik në bashkëpunim me Agjencinë e Prokurimit Publik, për personat përgjegjës dhe zyrtarët e strukturave të prokurimit publik.



ÇËSHTJET E BE-SË DHE HYRJE NË HARTIMIN E PLANIT TË PROGRAMIT TË TRAJNIMIT

Përmbyllëm me sukses workshop-in dy-ditor të organizuar nga Instituti Evropian për Administratën Publike (EIPA) dhe Qeveria e Luksemburgut, në kuadër të Programit të Asistencës Teknike të Luksemburgut për Shqipërinë.





2037

PJESËMARRËS NË TRAJNIME

296

PJESËMARRËS TË CERTIFIKUAR

19

TRAJNIME TË ZHVILLUARA

1333 pjesëmarrës nga pushteti qendror

435 pjesëmarrës nga pushteti vendor

205 pjesëmarrës nga insitucionet e pavarura

64 pjesëmarrës të tjerë



Gjatë muajit mars u zhvillua sesiioni informues “Ransomware-as-Service (RaaS), si funksionon dhe si të mbrohem” në bashkëpunim me Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike.



BASHKIMI EVROPIAN



50 PJESËMARRËS

Gjatë muajit mars, kemi vijuar me trajnimet në fushën e Bashkimit Evropian. Trajnimet kanë përfshirë tema të ndryshme, të cilat kontribuojnë në përmirësimin e njohurive dhe aftësive në lidhje me integrimin evropian.